

**UNIVERSITETI I GJAKOVËS "FEHMI AGANI"**  
**FAKULTETI I EDUKIMIT - PROGRAMI FILLOR**



**PUNIM DIPLOME**

TEMA Shqisat dhe perceptimi si proces dhe funksion gjatë  
jetës së njeriut

Mentori

Prof.ass.Dr. Behxhet Gaxhiqi

Studentja

Margarita Osmanaj

Gjakovë , 2017

Ky punim diplome u mbrojt më \_\_\_\_\_ para komisionit vlerësues.

Në përbërje

1. \_\_\_\_\_ Kryetar

2. \_\_\_\_\_ Antar

3. \_\_\_\_\_ Antar

Komisioni vlerëson punimin më notën \_\_\_\_\_

Nënshkrimet e antarëve të Komisionit Vlerësues

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

3. \_\_\_\_\_

## MIRËNJOHJE

Dëshiroj të falënderoj dhe t'i shpreh mirënjohjen time të veçantë udhëheqësit shkencor Prof. Dr. Behxhet Gaxhiqi, për ndihmën e pakursyer në realizimin e këtij punimi të diplomës kaq të rëndësishme për mua. Unë i jam mirënjohëse për marrëdhënien bashkëpunuese. Do të jetë udhërrëfyes, model në punën time akademike. Ndihma profesionale dhe inkurajimi i tij më sollën në këtë nivel.

Mirënjohje dhe falënderime të sinqerta për familjarët e mi që kanë qënë dhe janë për mua një frymëzim i pashtershëm për punën, në këtë rrugëtim sa të bukur aq edhe sfidues. Me dashurinë dhe ndihmën e tyre, jam në prag të diplomimit. Stabiliteti në familje më bënë të sigurt në punën studimore e intelektuale.

Ndjej mirënjohje të thellë për të gjithë ata që kontribuan në realizimin e qëllimit tim dhe që ende vazhdojnë të jenë përkrahë meje.

Falënderime të pafundme për të gjithë!

## ABSTRAKT

*Synimi kryesor i këtij punimi është njohja e shqisave dhe perceptimi si proces dhe funksion gjatë jetës së njeriut, apo më konkretisht për shqisat e ndjeshmërinë e tyre si dhe ndarjen e tyre që janë shqisat e të pamurit, shqisat e degjimitë, shqisat e lekurës, shqisat e nuhatjës dhe shqisat e shijes, ku secila prej tyre ka karakteristika të ndryshme dhe secila na senjalizon për proceset që ndodhin në trupin e njerit.*

*Gjithashtu për pasqyrimin dhe mënyrën e përjetimeve të perceptimit në vetëdijën tonë si dhe llojet e tij që janë perceptimi i kohës dhe perceptimi i hapsirës ku ipen shpjegime për secilën.*

*Në psikologji janë të njohura disa ligjshmëri si me të rëndësishmet, ligjshmërit e grupimit të ngacmuesve në tëresi, ku përfshihen disa parime, pastaj ligjshmëria e perceptimit të figures dhe bazës dhe ligjshmëria e pandryshmërisë së perceptuar.*

*Fjalët kyçe përjetimet, reagimet, ndikimet, llojet, karakteristikat.*

# PËRMBAJTJE

Mir njohje.....	3
Abstrakt.....	4
P rmbajtje.....	5
Hyrje.....	6
1.Shqisat dhe ndjeshmëria e tyre.....	7
2.Ndarja e shqisave.....	9
2.1.Shqisa e t parit.....	10
2.2.Shqisa e t d gjuarit.....	11
2.3.Shqisa e t nuhaturit.....	12
2.4.Shqisa e t shijuarit .....	13
2.5.Shqisa e l kur s.....	14
3.Perceptimi dhe veçorit e tij.....	15
4.Llojet e perceptimeve.....	17
4.1.Perceptimi i hapsir s.....	17
4.2.Perceptimi i kohës.....	18
5.Ligjshm rit e procesit t perceptimit.....	19
5.1.Ligjshm ria e grupimit t ngacmuesve n t r si.....	20
5.2.Ligjshm ria e perceptimit t figurës dhe bazës.....	21
5.3.Ligjshm ria e pandryshueshm ris s perceptimeve.....	21
P rfundimi.....	23
Autobiografia.....	25
Literatura.....	26

## HYRJE

Bota është e mbushur me shumëllojshmëri të mjedisit, për të cilat ne bëhemi të vetëdijshëm përmes perceptimit dhe ngacmuesve nga organizimi dhe lidhja e njeriut me mjedisin e jashtëm apo të brendshme që realizohet nëpërmes organeve shqisore.

Shqisat janë dritare përmes të cilave ne shikojmë botën për rreth nesh. Të gjitha përjetimet që ndodhin në trupin e njeriut vijnë nëpërmes tyre.

Çdo njeri, vepron dhe reagon ndryshe nga të tjerët dhe askush nuk mundë të perceptoj njëjtë . Perceptimi është procesi i parë psikologjik, me anë të cilit njeriu vë raport me realitetin e caktuar, që perceptimi i shpjegojë në mënyrë të veçantë të gjitha format e tërësishme të organizmit të tij. Është një proces mjaft i ndërlikuar dhe shumë i rëndësishëm në procesin e njohjes së realitetit të botës që na rrethon.

Perceptimi mund të përkufizohet si aftësia e njohjes përzgjedhëse të karakteristikave apo tipareve dalluese të gjësendeve apo dukurive të caktuar duke i shfrytëzuar shqisat përkatëse si dhe pasqyrimi i tyre në dimensionin hapësinor dhe kohor në vetëdijen e njeriut. Është hallka më e rëndësishme që e lidhë botën e ndjenjave të njeriut me realitetin e mjedisit. Me anë të perceptimit njeriu fiton dije më të plotë për objektin e caktuar që vepron në shqisat tona. Sa më të zhvilluara të jenë organet shqisore, aq më i plotë do të jetë perceptimi.

# 1. SHQISAT DHE NDJESHMËRIA E TYRE

Organizmi ynë është i ndjeshëm ndaj numrit të madh të mesazheve dhe sinjaleve të mjedisit, të cilat me një fjalë quhen ngacmime. Ngacmimet merren nga mjedisi me anë të shqisave, barten në sistemin nervor-tru, ku merret vendimi sesi duhet të reagojë organizmi. Në saj të këtyre ngacmimeve që merr truri ynë e kontrollon trupin tonë. Shqisat janë ato të cilat na informojnë se çka ndodh rreth nesh dhe në trupin tonë<sup>1</sup>.

Shqisat janë grup qelizash të specializuara për pranimin e ndryshimeve fizike dhe kimike që ndodhin në mjedisin e jashtëm ose të brendshëm të organizmit. Shqisat janë organe të aftësuara gjatë rrugës së gjatë evolutive për pranimin e ndikimit që bën energjia e një ngacmuesi në to dhe shëndërrimin e kësaj energjie në impulse nervore. Disa nga shqisat e njeriut janë aftësuar për pranim vetëm të energjisë së trupave dhe të dukurive të veçanta.

Secila prej shqisave me përbërje dhe funksion fiziologjik të saj në psikologji përmendet për shkak se me anën e tyre zhvillohet procesi i ndijimeve dhe i perceptimeve. Shqisat e njeriut janë të ndjeshme ndaj ndryshimeve të ngacmuesve dhe të intensitetit të tyre. Ndjeshmëria sht aftësia e aparatit të ndijimit ose e analizatorit për të reaguar ndaj intensitetit më të ultë të ndikimit të një cilësie dhe ndaj ndryshimeve sa më të vogla në intensitet të ngacmuesit fizik, që vepron në analizatorin e caktuar.<sup>2</sup>

Përshtatja e ndjeshmërisë shqisore është dukuria e ndryshimit të ndjeshmërisë së saj, që është pasojë e adaptimit të organeve të ndijimit ndaj ndikimit të pandërprerë, që ushtrojnë ngacmuesit në organet shqisore. Përshtatja shfaqet në rend të parë në uljen e ndjeshmërisë së tyre, përkatësisht në uljen e pragut absolut të ndjeshmërisë për ngacmues me fuqi të pandryshueshme të veprimit të tyre shqisa. Është e theksuar sidomos në fushën e të parit, të ndjeshmërisë së lëkurës etj. Nën ndikimin e vazhdueshëm të rrobave në lëkurën e trupit të njeriut ky gati se nuk e ndien praninë e rrobave mbi lëkurën e trupit të tij, i futur në ujë të lumit ose të liqenit në vapën e gushtit, njeriu në fillim ka të ftohët, kurse pas 2-3 minutash ndjeshmëria e lëkurës ulet dhe njeriu i përshtatet temperaturës së tij.

Sensibilizimi në fushën e ndijimeve është dukuri e veçantë. Sensibilizimi në kuptimin e përgjithshëm do të thotë ngritje e shkallës së ndjeshmërisë shqisore nga ndryshimet e

<sup>1</sup> Grup autor sh(Agim Gashi, Fetah Halili, Ismet Bajraktari, Hamdi Ajazj), Njeriu dhe natyra, Sht pia botuese DUKAGJINI-Pej , P r klasen e pest t shkoll s fillore, Fq.12.

<sup>2</sup> Pajazit Nushi, Psikologjia e përgjithshme I, Libri shkollor, Prishtin , 2002,Fq.164.-168

intensitetit, të kualitetit dhe të kohës së zgjatjes të ndikimit të ngacmuesit të një shqisë . Në këtë kuptim sensibilizimi shfaqet edhe nga disa ndryshime ne organizëm të njeriut, gjithashtu shfaqet edhe në ngritjen e shkallës së ndjeshmërisë së një shqise, kur ngacmohet shqisa tjetër.

Dukuria e sensibilizimit u dallua në disa prova të gjurmimit të dukurisë së të parit me një dhe me dy sy. Kështu, pas përshtatjes së një syri në errësirë dhe ndriçimit të lokalit me dritë elektrike, përshtatja e ndjeshmërisë së syrit të adaptuar më parë në errësirë ushtron ndikim në procesin e përshtatjes së syrit të dytë , i cili më parë nuk i është ekspozuar errësirës. Ngacmimi i shqisë së të prekurit e ngrit ndjeshmërinë e shqisë së të parit. Kjo dukuri quhet sinestezi.

Sinestezia është përjetim i njëkohshëm i ndijimeve të shqisave të ndryshme kur ngacmohet vetëm njeh shqisë . Kështu bie fjala tonet e një tërësie muzikore te disa dëgjues shkaktojnë përjetime te ngjyrës së kaltër, ngjyra e kuqe e lapsit te disa individë shkakton shije speci djegës etj. Sensibilizimi dhe sinestezia janë të lidhura me ngritjen e ndjeshmërisë së qendrave sensorike të caktuara dhe të shqisave të tyre.<sup>3</sup>

## **2.NDARJA E SHQISAVE**

---

<sup>3</sup> Pajazit Nushi, Psikologjia e p rgjithshme I, Libri shkollor, Prishtin , 2002,Fq.165.



Nëse dëgjojmë muzikë nga radio dhe në të njëjtën kohë mbajmë në dorë një portokall, me të prekur dallojmë formën e tij, a është i rrashtë apo i vrazhdë , me të shikuar dallojmë ngjyrën, me të nuhatur dallojmë aromën, kurse me te kafshuar dallojmë shijen. Këto ngacmime nga mjedisi i jashtëm i pranojnë shqisat tona. Sytë , veshët, hunda, gjuha dhe lëkura me një fjalë quhen shqisa.<sup>4</sup>




FIG 1.1. SHQISAT THEMELOR TË NJERIUT <sup>5</sup>

Varësisht nga funksioni që kryejnë në procesin e njohjes së mjedisit të jashtëm ose të brendshëm të njeriut shqisat ndahen në shqisat periferike të organizmit (syri, veshi, lëkura, gjuha dhe hunda) dhe në shqisa të brendshme të organizmit të njeriut (shqisat kinestetike, shqisa e rrotullimit, e pozitës së trupit dhe shqisa organike). Derisa me funksion të shqisave të periferisë së organizmit zhvillohet procesi i ndijimeve për cilësitë e trupave dhe të

<sup>4</sup> Grup autor sh( Agim Gashi, Fetah Halili, Ismet Bajraktari, Hamd Ajazai), Njeriu dhe natyra, Sht pia botuese DUKAGJINI-Pej , P r klasen e shtat t shkoll s s mesme t ult , Fq.12

<sup>5</sup> <https://www.google.com/search?q=shqisat+e+njeriut&sa=X&rlz>

dukurive të jashtëm të njeriut, me funksion të shqisave të brendshme të organizmit të njeriut zhvillohet procesi i ndijimeve të brendshme të organizmit të njeriut<sup>6</sup>.

## 2.1.SHQISA E TË PARIT

Shqisa e të pamurit është syri. Syri i njeriut është organi me të cilit ne shohim botën e cila na rrethon. Përmes tij ne marrim rreth 90% të informatave që na vinë nga të gjitha shqisat. Po ashtu edhe në trurin e njeriut është qendra përgjegjëse për të parit është më e madhe se për shqisat e tjera. Syri i njeriut është në gjendje të pranojë valët elektromagnetike . Gjatë zhvillimit evolutiv syri është specializuar dhe është përsosur për pranimin e dritës.<sup>7</sup>

Me ndihmën e kësaj shqise ne i pranojmë ngacnimet e dritës. Brenda në sy ndodhet nervi i syrit, i cili i merr ngacnimet e dritës që vijnë nga sende të ndryshme dhe i përcjell në tru ku edhe njihet objekti.




FIG.1.2.SHQISAT E TË PAMURIT

<sup>6</sup> Pajazit Nushi, Psikologjia e përgjithshme I, Libri shkollor, Prishtinë, 2002, Fq.164

<sup>7</sup> Mimoza Shahini, Seminare të zgjedhura nga lëndat e psikofiziologjisë, Prishtinë, 2007, Fq. 108

## 2.2.SHQISA E TË DËGJUARIT

Shqisa e të dëgjuarit është veshi. Me anë të veshit ne dëgjojmë tingujt, zërin, zhurmën. Këto ngacmime me ndihmën e nervit të të dëgjuarit përcillen në tru, ku krijohet ndjesia e dëgjimit. Tingujt barten përmes ajrit, ujit, materieve të forta. Në vesh gjenden edhe struktura që mundësojnë ruajtjen e drejtpeshimit të trupit të njeriut.



FIG. 1.3.SHQISAT E TË DËGJUARIT <sup>8</sup>

Veshi është organi me anën e të cilit realizohet procesi i të dëgjuarit, ngacmues për shpinën e të dëgjuarit janë valët mekanike (valët e zërit). Veshi i njeriut mund t'i pranoj vetëm ato valë që shtrihen në mes 16-20000 hz (herc). Kur cilësia e dëgjimit është më e mirë nëse valët shtrihen në mes 1000-4000 hz,(tingujt që krijohen gjatë të folurit të njeriut shtrihen me këtë gjatësi valore).

Të dëgjuarit hyn në grupin e ndijimeve të rëndësishme për jetën dhe për zhvillimin e njeriut dhe pas ndijimeve të pamurit zë vendin e dytë për nga rëndësia e tyre për njohje të realitetit. Ndijimet e të dëgjuarit kanë rëndësi të veçantë dhe të pazëvendësueshme për të mësuarit e gjuhës, për zhvillimin e të folurit dhe për komunikim të individit me të tjerët. Ngacmuesit fizik të shqisës së dëgjimit janë tingujt të cilët në fizikë ndahen në tone dhe zhurma. Tonet dallohen nga zhurma në pikëpamje të lëvizjeve ritmike të valëve të ajrit, kurse zhurmat janë rezultat i lëvizjeve të parregullta të valëve ajrore.<sup>9</sup>

<sup>8</sup>[https://www.google.com/search?q=shqisat+e+te+degjuarit&rlz=1C1CHZL\\_enXK723XK723&biw=1440&bih=745&source=lnms&tbn=isch&sa=X&ved=0ahUKewiuue73aHUAhXkK5oKHfsTCzIQ\\_AUIDCgD#tbn=isch&q=preceptimi&imgc=PC1Y1J8MPIInGfM:](https://www.google.com/search?q=shqisat+e+te+degjuarit&rlz=1C1CHZL_enXK723XK723&biw=1440&bih=745&source=lnms&tbn=isch&sa=X&ved=0ahUKewiuue73aHUAhXkK5oKHfsTCzIQ_AUIDCgD#tbn=isch&q=preceptimi&imgc=PC1Y1J8MPIInGfM:)

<sup>9</sup> Mimoza Shahini, Seminare t zgjedhura nga l nda e psikofiziologjis ,Prishtin , 2007, Fq.110.

## 2.3.SHQISA E TË NUHATURIT

Shqisa e të nuhaturit është hunda. Më anë të saj dallojmë aromën. Aroma mund të ndihet vetëm nga lëndët që avullohen. Shqisa e nuhatjes të njerëzit është shumë më e dobët se te kafshët, por përsëri ajo është 10,000 herë më e mprehtë se shqisa e shijes. Shqisat e nuhatjes i nënshtrohen përshtatjes, kështu që erërat që na duken të padurueshme në fillim gradualisht bëhen me pak të besdishme.

Të nuhaturit është lloj i veçantë i ndijimit përmes të cilit njeriu bëhet i vetëdijshëm për erërat dhe cilësitë trupore. Njeriu mund të dallojë 4000 aroma të ndryshme, kurse njeriu me një të stërvitur mund të dallojë rreth 10000 aroma të ndryshme, por erërat parësore janë erë kalbësirash, erë lulesh, erë pemësh, erë melmesash, erë djegiesh etj. Ngacmues adekuat për të nuhaturit janë molekulat e trupave në gjendje të gaztë.<sup>10</sup>

Shqisa e nuhatjes gjendet në epitelin e pjesës së epërme të zgavrës së hundës. Në këtë epitel gjenden qelizat për nuhatje, të cilat ngacmimin e përcjellin deri të qendra e trurit.<sup>11</sup>



FIG.1.4. SHQISA E TË NUHATURIT

<sup>10</sup> Mimoza Shahini, Seminare të zgjedhura nga lënda e psikofiziologjisë, Prishtinë, 2007, Fq.113.

<sup>11</sup> Grup autorësh (Esat Dauti, Esat Hoxha, Behxhet Mustafa, Ragip Rustemi, Për klasën e shtatë të shkollës së mesme të ulët, Pejë, Fq.130.

## 2.4.SHQISA E TË SHIJUARITË

Për ta kuptuar shijen, si fillim duhet ta dallojmë nga aroma - një ndërthurje të nuhatjes me shijen. Përpiquni të mbyllni hundën dhe të hani. Do të vini re se pjesa më e madhe e aromës së ushqimit do të zhduket dhe ju do të shquani vetëm cilësitë e shijes. Me anë të shqisës së të shijuarit njeriu njeh shijen ushqimit. Pra, shqisa e të shijuarit mund të bëjë dallimin e stimujve të ndryshëm kimik që shijohen.

Në gjuhë gjenden shqisat e shijimit, numrin e cilave është katër: i ëmbël, i njelmët, i thartë dhe i hidhur. Ato gjenden në pjesët e caktuara të gjuhës. Qelizat ndijore të këtyre shqisave bartin ngacmimin në nerv, i cili është i lidhur me qendrën nervore, që reagon ndaj ngacmimit.<sup>12</sup>

Ndërsa si ngacmues adekuat për receptorët e shijimit janë substancat e ndryshme, të cilat kanë aftësinë e tretjes në kontakt me pështymen e njeriut. Sipërfaqja e gjuhës është e mbuluar me të ngritura të vogla të quajtura papila. Muret e papilave për mbajnë sythet e të shijuarit të cilët janë receptorë të shijes. Njeriu i rritur afërsisht ka rreth 10000 sytha të tillë, mirëpo në shkaktim çdo ditë një pjesë të sythave të shijuarit duke përdorur ushqim me temperaturë të lartë ose shumë të ultë, mirëpo këto sythe rigjenerohen brenda disa ditëve.<sup>13</sup>




FIG 1.5.ZONAT PËR SHIJET THEMELOR NË GJUHË

<sup>12</sup> Grup autorësh (Esat Dauti, Esat Hoxha, Behexhet Mustafa, Ragip Rustemi, Për klasën e shtatë të shkollës së mesme të ulët, Pejë, Fq.130

<sup>13</sup>Mimoza Shahini, Seminare të zgjedhura nga lënda e psikofiziologjisë, Prishtinë, 2007, Fq.114.

## 2.5.SHQISA E LËKURËS

Lëkura është organi shqisor më i madh që kemi. Një njeri i gjatë 160 cm ka rreth 550 cm katror lëkurë . Lëkura na mbron nga mjedisi, ruan lëngjet e trupit, rregullon temperaturën e brendshme dhe përmban receptorë të shijes sonë të prekjes e cila luan një rol të rëndësishëm m në bashkë veprimin dhe emocionin njerëzor. Të shumë popuj, kur njerëzit takohen apo ndahen, përshëndetjet shoqërohen me shtrëngim duarsh, përqaftimesh e të tjera gjeste që kanë të bëjnë më prekjen. Të dashuruarit e shprehin ndjenjën për njëri-tjetrin me puthje, shtrëngim duarsh dhe përkëdhelje. Kur prekim dhe na prekin, të paktën përkohësisht duket sikur thyejmë izolimin tonë . Nga të gjitha ndjesitë tona, prekja është ajo që jep efektin më të mirë . Receptorët e shumtë nervorë të lëkurës që janë përqendruar në nivele të ndryshme në të gjithë sipërfaqen e saj, dërgojnë fibrat nervore në tru dy rrugë.<sup>14</sup>

Lëkura është organi shqisor më anën e të cilës njeriu njeh sipërfaqet e lëmuara, të vrazhda, të buta, të forta, të lagështa, të thata, të ngrohta, të ftohta etj, të trupave ose lëndëve që janë në kontakt me të . Këto cilësi fizike të trupave shndërrohen në ndijime me anë ne ndjeshmërisë së lëkurës. Në lëkurë ekzistojnë katër shqisa kryesore, këto janë shqisat e të prekurit, e të ftohtit, e të nxehtit dhe shqisa e dhimbjes.<sup>15</sup>



FIG1.6 SHQISA E TË PREKURIT

<sup>14</sup> Charles G. Morris, Albert A. Maisto, Psikologjia dhe shkenca e proceseve mendore dhe e sjelljes njer zore, Tiran 2008, Fq.107-108

<sup>15</sup> Mimoza Shahini, Seminare t zgjedhura nga l nda e psikofiziologjis ,Prishtin , 2007, Fq.114.

### 3.PERCEPTIMI DHE VE ORITË E TIJ

Perceptimi është proces më i ndërlikuar se ndijimi. Lidhet ngushtë me të , por në të njëjtën kohë ndryshon shumë nga ai. Perceptim quajmë pasqyrimin në vetëdijen tonë të veprimit të drejtpërdrejtë në organet e shqisave, të objekteve, sendeve dhe fenomeneve në tërësinë e tyre. Perceptimi është i ngjashëm me ndijimin dhe lidhet ngushtë më të pasi ai përbëhet nga një grup ndijimesh, kjo ndodh për arsye se çdo objekt apo fenomen përbëhet nga një sërë cilësish dhe karakteristikash të veçanta. do cilësi dhe karakteristikë e objektit pasqyrohet në vetëdijen tonë me anë të një ndijimi të caktuar.



Pasqyrimi i të gjitha cilësive të një objekti të dhënë në vetëdijen tonë përfaqëson perceptimi nga ne të objektit në fjalë . Kështu në qoftë se marrim një laps në dorë , ne dallojmë tek ai lëmueshmëria, peshën, formën, përmasat, ngjyrën e jashtme, ngjyrën e grafitit, dëgjojmë zhurmën e lehtë të tij kur shkruajmë etj.<sup>16</sup>

Perceptimet i përjetojmë gjithmonë si objekte reale, por asnjë herë nuk duhet të harrojmë se ato janë vetëm figura subjektive, vetëm përjetime subjektive. Cilësi tjetër e perceptimeve është ajo se ato për ne janë përjetime konstante. Ne nuk dallojmë ndryshimet edhe atëherë kur figura e objektit të perceptuar është tjetër, bie fjala më e vogël. Ne, subjektivisht atë nuk e përjetojmë si më të vogla. P.sh. njeriun të cilin e njohim, nuk e shohim si më të vogël kur ai ndodhet më larg.

---

<sup>16</sup> <http://psikologji.net/forumi/index.php?topic=2187.0>

Perceptimi sht mekanizmi m i r nd sish m i nd timit mendor dhe i t menduarit t genies njerëzore. Gjat procesit t perceptimit t objekteve apo trupave t ndryshëm n mjedisin rrethues zhvillohen procese t r nd sishme identifikues t cilësive karakteristike t tyre, pastaj fillon procesi i veçimit dhe i grupimit t cilësive t ngjashme.<sup>17</sup>

Perceptimet janë përjetime shumë të qarta dhe të gjalla. Perceptimet janë më të pasura më detaje se çdo përjetim tjetër. Cilësi e perceptimeve është ajo se ato janë përjetime mjaft stabile dhe të qëndrueshme në vetëdijen tonë.<sup>18</sup>

Perceptimi ka disa veçori të tij.

Objektiviteti i perceptimeve është veçori e posaçme e tyre. Objektivitet i perceptimeve nënkuptohet përmbajtja e perceptimeve dhe organizimi i të dhënave shqisore në tërësi, të cilën e shkakton qenia e objektit, asaj që ekziston në realitet dhe me energjinë e vet vë në veprim shqisat dhe receptorët e tyre. Perceptimet kanë karakter relativisht të qëndrueshëm.

Qëndrueshmëria ose stabiliteti i perceptimeve është veçori e perceptimeve. Në perceptimin e trëndafilin mund të ndryshojë ndonjë e dhënë shqisore trëndafili mund të jetë i freskët, me pak erë , i kuq, i bardhë etj, mirëpo njeriu e përjeton këtë si tërë si të qëndrueshëm e, katërkëndëshi mund të jetë i madhë , i vogël, i vizatuar me viza kufizuese të holla ose me pika etj, por njeriu këtë figurë e përjeton tërësi stabile. Qëndrueshmëria ose stabiliteti i perceptimit është rezultat i organizimit të mirë të të dhënave shqisore në tërësi. Qëndrueshmëria receptive është prirja për të perceptuar objektet në mënyrë të qëndrueshme, pavarësisht nga ndijimet e ndryshme që kapen nga shqisat tona në një situatë konkrete.<sup>19</sup>

*Qëndrueshmëria e madhësisë* është ruajtja e tipareve në përmasat e konstruktit të objekteve gjatë perceptimit të tyre i perceptojmë objektet e njohura më të njëjtën madhësi edhe ose imazhi që bie në retinë ndryshon.

*Qëndrueshmëria e formës* na lejon të perceptojmë objektet apo dukuri të njohura sikur kanë një formë të qëndrueshme edhe nëse i shohim nga kënde të ndryshme vërtetimi.

---

<sup>17</sup><http://www.germ-a.com/wp-content/uploads/2014/07/perceptimi-ndertimi-mendor.pdf>

<sup>18</sup> Neki Juniku, Kaptina nga psikologjia, Prishtin , 2015, Fq.61-61-63

<sup>19</sup> Pajazit Nushi, Psikologjia e p rgjithshme I, Libri shkollor, Prishtin , 2002, Fq.190



*Qëndrueshmëria e ndriçimit* sht perceptimi ynë për një objekt të shndritshëm ose të errët qëndron konstant pavarësisht ndryshimit në shkallën e ndriçimit.

*Qëndrueshmëria e ngjyrës* sht përjira perceptuese për të parë objektet e njohura sikur kanë vazhdimisht të njëjtën ngjyrë, pavarësisht nga shkalla e intensitetit dhe ndriçimit.

## **4.LLOJET E PERCEPTIMEVE**

Perceptimet ashtu si dhe ndijimet janë të shumëllojshme . Lloji i perceptimeve varet nga sendet (objektet) dhe fenomenet që perceptojmë si dhe nga analizatorët që luajnë rolin kryesor në perceptim. Kështu, perceptimet ashtu si dhe ndijimet janë pamore, dëgjimore, të nuhatjes, të shijes, të lëkurës, muskulore-lëvizore dhe organike. Figurat që pasqyrohen zakonisht në vetëdijen tonë më anë të perceptimeve shfaqen zakonisht si pasojë e veprimit të një hershëm të disa analizatorëve. P.sh. figura e një sendi që pasqyrohet në trurin tonë , mund të realizohet si rezultat i pjesë marrjes së njëhershme të analizatorëve pamore, muskularo-lëvizore dhe analizatorëve të lëkurës. Duke vepruar njëkohësisht, ata na mundësojnë një pasqyrim më të qartë të sendit bashkë me cilësitë dhe karakteristikat e tij. Llojet e perceptimeve janë perceptimi i hapësirës dhe perceptimi i kohës.<sup>20</sup>

### **4.1.PERCEPTIMI I HAPSIRËS**

Të gjitha objektet e botës së jashtme materiale në hapësirë dhe në kohë .Të gjitha objektet i perceptojmë si objekt me madhësi të caktuar, në pozitë të caktuar ndaj nesh, si objekte në thellësi të caktuar dhe si objekte me një largësi të caktuar prej nesh. Perceptimi i të gjitha këtyre karakteristikave të hapësirës varet nga disa faktorët prej llojit dhe radhitjes

---

<sup>20</sup> <http://psikologji.net/forumi/index.php?topic=2187.o>

së ngacmuesve, prej funksionit të organit tonë shqisor dhe sistemit nervor, prej përvojë sonë , motivacionit etj<sup>21</sup>.

Lëndët dhe fenomenet e botës reale që ne perceptojmë , nuk kanë vetëm veti(cilësi) si ngjyra, era, shija etj, por ato kanë edhe përmasa d.m.th gjatësi, gjerësi dhe lartësi (tri dimensionale).

*Perceptimi i madhësisë së objektit* varet prej madhësisë së figurës në retinë dhe prej largësisë së objektit prej nesh. Zakonisht, madhësinë e vlerësojmë varësisht prej largësisë apo si funksion të largësisë . Objekti më i largët do të na duket më i madh sesa ai që është më afër, edhe pse figurat e tyre në retinë janë të njëjta. Objekti që është larg, na duket më i vogël sesa ai që është më afër. Gjithashtu, objektet që gjenden në largësi të ndryshme dhe ne i perceptojmë si të njëjta për nga madhësia, edhe pse figurat në retinë tonë janë të ndryshme.

*Perceptimi i pozitës së objekteve në hapësirë* nënkuptojmë të gjitha objektet që gjenden në hapësirë lart, poshtë , majtas, djathtas, para, prapa etj. Me rastin e perceptimit të pozitës në hapësirë marrin pjesë ndijimet kinestetike dhe statike. Të dhënat e marra nga shqisat e të pamurit ne i përputhim dhe i kombinojmë me ato të marra nga organet kinestetike dhe statike .

*Perceptimi i thellësisë së objekteve* është të dalluarit e të pamurit me dy sy ose të parit binokular dhe figura e retinës së trupit që paraqitet në mënyrë të kundërt në retinën e syrit të njeriut. Faktori i rëndësishëm i perceptimit të thellësisë së trupave është jonjëjtësia e figurave të të njëjtit trup, që shkakton në retinën e syrit të majtë dhe në retinë e syrit të djathtë .

## **4.2.PERCEPTIMI I KOHËS**

Perceptimi i secilës dukuri, objekt, proces etj, bëhet brenda një kohe të caktuar, e cila e ka fillimin dhe mbarimin e saj. Për çdo perceptim është i lidhur edhe përjetimi i zgjatjes. Në jetën e përditshme kohën e perceptojmë si fenomen që lëviz shpejt ose ngadalë . Kjo do të thotë se disa pjesë të kohës të cilat janë objektivisht të barabarta, ne i perceptojmë më gjatësi te ndryshme.

---

<sup>21</sup> Neki Juniku, Nocione themelore psikologjike, Prishtin , 1985, Fq.38.

Perceptimi i kohës pasqyron zgjatjen dhe vargëzimin e ndryshimeve që bëhen në sendet e botës reale. Në vegjëli perceptimi i kohës dhe hapësirës mungon sepse mungon përvoja jetësore, por ai formohet gradualisht me rritjen tonë dhe marrjen e njohurive dhe përvojës së nevojshme jetësore.<sup>22</sup>

Në perceptimin e zgjatjes kohore të një dukurie ushtrojnë ndikimin edhe intensiteti i ngacmuesit. Ngacmuesit me kohë zgjatjeje shumë të shkurtër (që kanë kohë zgjatjeje nën dhjetë të qindat e sekondës) përbëjnë pragun absolut të përjetimit të fillimit kohorë, nën të cilën zgjatjet kohore nuk kanë përmasa subjektive të përjetimit. Mbi këtë kufi zgjatja e kohës përjetohet varësisht nga struktura përmbajtjesore, e cilës e përmbush kohën kur kjo kohë është e përmbushur me aktivitet interesante, me aktivitete që zgjojnë përjetime emocionale intensive, kur individët e kësaj kohe janë të motivuar etj, zgjatja kohore e këtyre përmbajtjeve përjetohet zgjatje kohore e shkurtër.<sup>23</sup>

Për të kuptuar më mirë dhe më drejtë objektet dhe fenomenet e botës materiale që na rrethon, është i nevojshme formimi e një perceptimi të organizuar, të paramenduar dhe me një plan të caktuar. Ky lloj perceptimi quhet vëzhgim ose vrojtim. Pra, vëzhgimi është perceptimi që bëhet me një plan dhe një qëllim të caktuar.<sup>24</sup>

## **5. LIGJSHMËRITË E PROCESIT TË PERCEPTIMIT**

Më parë kemi thënë se perceptimet na informojmë me objektet në tërësi. Perceptimet janë gjithmonë pasqyrim i tërësive të objekteve të caktuara. Shkaku kryesor që perceptimet janë gjithmonë pasqyrime të tërësive që ndron në faktin se edhe vetë objektet janë komplekse ngacmuesish të cilët e përbëjnë një tërësi unike.

Në psikologji janë të njohura ligjshmëri të perceptimit. Ndër këto ligjshmëri të perceptimit, më të rëndësishmet janë ligjshmëria e grupimit të ngacmuesve në tërësi,

---

<sup>22</sup> <http://psikologji.net/forumi/index.php?topic=2187.0>

<sup>23</sup> Pajazit Nushi, Psikologjia e përgjithshme I, Libri shkollor, Prishtinë, 2002, Fq.204.

<sup>24</sup> <http://psikologji.net/forumi/index.php?topic=2187.0>

ligjshmëria e perceptimit të figurës dhe bazës dhe ligjshmëria e pandryshueshmërisë së perceptimeve.<sup>25</sup>

## 5.1. LIGJSHMËRIA E GRUPIMIT TË NGACMUESVE NË TËRËSI

Kjo ligjshmëri manifestohet në mënyrë që ngacmuesit e ndryshëm tentojnë gjithmonë t'i përjetojnë në tërësi. Këto parime të grupimit të ngacmuesve në tërësi janë parimi i afërsisë , parimi i ngjashmërisë , parimi i simetrisë dhe parimi i kontinuitetit.

*Parimi i afërsisë* mundë të sqarohet në atë mënyrë që te njerëzit ekziston gjithmonë tendenca apo gatishmëria që ngacmuesit e afërt në pikëpamje të kohës dhe të hapësirë s t'i perceptojnë së bashku ose në tërësi. P.sh. vijat në figurën 1 nuk i perceptojmë si gjashtë vija vertikale, por si tri çifte vijash vertikale.

FIG.1    II    II    II

*Parimi i ngjashmërisë* duhet të kuptohet ashtu që ngacmuesit të cilët i vlerësojmë si të ngjashëm mes vete tentojnë t'i gremëzojmë në tërësi.<sup>26</sup> (shih fig.2.)

FIG.2    XX    OO    XX    DR.NEKI JUNIKU

*Parimi i simetrisë* .Tërësia receptive formohet shpejt dhe lehtë nga të dhënat shqisore, që shkaktohen nga elementet e grupuara simetrikisht ndërmjet tyre. Në këtë kuptim ngacmuesit e përbërësit e një figure të rregullt, që ka formë të mirë , vetvetiu i imponohen njeriut si një tërësi receptive. Parimi i kë tillë , që quhet edhe parim i formës së mirë .

[ ] [ ] [ ]    ( ) ( ) ( )

<sup>25</sup> Neki Juniku, Nociione themelore psikologjike, Prishtin , 1985, Fq.35.

<sup>26</sup> Neki Juniku, Kaptina nga psikologjia, Prishtin , 2015,Fq.64.

FIG.3. Kllapat katrore e përmbyllin një tërësi hapësinore, kurse kllapat gjysmërethore përmbyllin një hapësirë tjetër. Hapësirat e përmbyllura perceptohen nga simetria që kanë kllapat, që përmbyllin këto hapësira.<sup>27</sup>

*Parimi i kontinuitetit* shfaqet në gatishmërinë tonë që në fillim të vëzhgimit formën e hetuar ta perceptojmë si formë e cila vazhdon ose vijon. Ndonjë vijë, të cilën në fillim e kemi vërejtur të lakuar, ajo edhe më tutje vërehet si e tillë, edhe pse është vija tjetër. Ky parim tregon se ngacmuesit të cilët e formojnë së bashku ndonjë figurë të drejtë dhe të dalluar, grupëzohen në tërësi.<sup>28</sup>

## **5.2.LIGJSHMËRIA E PERCEPTIMIT TË FIGURËS DHE BAZËS**

Ne objektet i perceptojmë si figura të vendosura në një bazë ose paravijë me pak të caktuar dhe me pak të theksua. Çdo gjë e perceptojmë si figura të shprehura qartë në një bazë më pak të dalluar. P. sh. shkronjat i perceptojmë si figura në letër, pikturat si objekte të dalluara, apo të theksuara në mur etj. Ne figurat i perceptojmë si relieve, të dala përpara, me shumë detaje dhe me formë të caktuar e të qartë. Kur perceptojmë ekziston gatishmëria që sipërfaqet më të vogla dhe të mbyllura t'i perceptojmë si figura të vendosura në sipërfaqe më të madhe e më pak strukturale.

## **5.3.LIGJSHMËRIA E PANDRYSHUESHMËRISË SË PERCEPTIMEVE**

Ngacmuesit e jashtëm vazhdimisht ndryshojnë e ata janë bazë e perceptimeve tona, ne përsëri objektet e jashtëm i vërejmë si të pandryshueshme. Perceptimet mbesin të pandryshueshme, të njëjta si në largësi prej 3m ashtu edhe prej 10m është e njohur si ligjshmëri e pandryshueshmërisë së perceptimit të madhësisë.

---

<sup>27</sup>Pajazit Nushi, Psikologja e përgjithshme I, Libri shkollor, Prishtinë, 2002, Fq.194 – 195.

<sup>28</sup>Neki Juniku, Nocione themelore psikologjike, Prishtinë, 1985, Fq.36.

Po ashtu ne i perceptojm konstante edhe trajtat, edhe pse trajta e figurës së objektit ndryshon vazhdimisht në retinën e syrit tonë. P.sh. tavolinën e perceptojm gjithmonë të rrumbullakët ndonëse prej pozitive të ndryshme ajo duhet të dukej ashtu, sepse figura e saj në retinën tonë ndryshohet vazhdimisht.

Pandryshueshmëria ekziston edhe në perceptimin e ngjyrës dhe ndritshmësisë. P.sh. shkumësin e perceptojm të bardhë të njëjloj, si në hije po ashtu edhe në diell edhe pse në të vërtetë ndritshmëria e shkumësit në hije është afërsisht 200 herë më e vogël. Po ashtu është rasti edhe me thëngjillin të cilin e perceptojm me të njëjtën ngjyrë si në hije ashtu edhe në diell. Pandryshueshmëria ekziston derisa ndryshimet në ngacmues mos të bëhen shumë të mëdha, apo shumë të dallueshme.<sup>29</sup>

Kuptimi i ekzistimit të këtyre ligjshmërive qëndron në adaptimin tonë më suksesshëm në kushtet e ambientit. Ne nuk do të mund të njihnim, të identifikojm objektet po mos të ekzistonte konstante në të perceptuar. Ndërkaq, nëse nuk do të mund të reagonim as ndaj ndryshimeve më të mëdha, po ashtu nuk do të mund orientoheshim në botën që na rrethon. Pikërisht për këtë arsye, konstanta e perceptimeve nuk ekziston atëherë kur ndryshimet në ngacmues janë të mëdha, të rëndësishme.

---

<sup>29</sup> Neki Juniku, Kuptimi nga psikologjia, Prishtinë, 2015, Fq.66.

## PËRFUNDIMI

Si shqisat, ashtu dhe perceptimi, kanë një rendësi shumë të veçantë në jetë e njeriut. Pa shqisa dhe perceptim nuk mund të imagjinonim jetë. Çdo gjë që ne e mendojmë, prekim, shikojmë, ndjejmë, dëgjojmë, shijojmë arrihet përmes shqisave dhe perceptimit. Të gjitha shqisat tona që janë gjithsej pjesë e informojnë trurin se çka ndodh rreth nesh dhe në trupin tonë, ku me pas ne e perceptojmë at objekt, dukuri, formë etj. Secila nga shqisat ka një rendësi shumë të veçantë në trupin tonë. Pa shqisa, mendja njerëzore do të ishte si një ajër. Shqisat janë ato që na lidhin me mjedisin, por edhe me vetveten.

Të porsalindurit mund të shohin, të dëgjojnë dhe të kuptojnë shumë më tepër se sa besonim për brezat e mëparshme. Shqisat e tyre funksionojnë shumë mirë dhe për mirësohen me shpejtësi, po thuajse në nivelin e të rriturve. Të foshnjat me të zhvilluar janë shqisat e të pamurit ku ata veqë lindin me sy të hapur, që shikojnë, megjithëse fillimisht, bota e atyre u duket pakëz e turbullt, pastaj shqisa e dëgjimit menjëherë pas lindjes, të porsalindurve iu pëlqen tingulli i zërit të nënës së tyre se sa një zë femre i panjohur.

Çdo njeri percepton gjëra ashtu si dëshiron, apo si ka dëshirë. Mënyra e të menduarit ose të perceptuarit na dallon nga të tjerët. Përmes shqisave dhe perceptimit ne arrijmë kënaqësi në trupin tonë dhe mendjen tonë, duke ditur se jemi me fat që i posedojmë të gjitha shqisat, si dhe të menduarit që është një ndër faktorët kryesor të njeriut. Sa më të zhvilluara të jenë organet shqisore, aq më i plotë do të jetë perceptimi.

Perceptimi ka një lidhje të ngushtë me kujtesën, sepse në qoftë se neve do të na mungonte kujtesa, atëherë çdo objekt ose fenomen do të perceptohej nga ne si i ri dhe i panjohur më parë. Ai lidhet edhe me procese të tjera psikike, siç janë të menduarit, të folurit, ndjenjat, vullneti etj. Si bazë fiziologjike perceptimi shërben si tërësia e nxitjeve nervore të cilat shkaktohen nga ngacmuesit të shumtë të ndërrlikuar, që një kohë si të analizatorit të ndryshme dhe realizohen në saj të veprimtarisë analitiko-sintetike të korrës së trurit.

do përjetim i yni arrihet përmes shqisave. Në trup ose dukuri me cilat shtetë veta nuk është në gjendje të venë në veprim shqisën dhe receptore të shqisës. Këtë mund ta bëjë vetëm ai trup në shqisën e caktuar. Tërësia e trupit i deferon pjesët, përkatësisht çelësit e tij në

kuadrin e perceptimit pjes t e cilesit e trupave marrin kuptimin e tyre. Perceptimi sht proces integral, fizik, fiziologjik, e psikologjik etj.

Gjat procesit t perceptimit b het bashkimi i informatave apo njohurive t m parshme me informacionet e reja duke b r grupimin e tyre n form t modelimeve si dhe p rgjith simin apo gjeneralizimin e tyre me q llim t nxjerrjes s konkludimeve logjike p r gj sende apo dukurit q i perceptojm .

Por perceptimi nuk sht vet m process i njohj s s realitetit, por edhe proces njoh s i lidhur me veprime t caktuara t individit ndaj objektit preceptues.



## **AUTOBIOGRAFIA**

Un quhem Margarita Osmanaj, e lindur m 25.9.1994 n Istog. Jetoj me familjen time, n Dubrav . Kam pasur fatin e mir t rritem n nj familje me shum dashuri e ngrohtësi. Shkoll e mesme t ul t e kam përfunduar n Shkoll n “Bajram Curri” n Istog. Shkoll n e mesme t lart e kam p funduar n Gjimnazin “Haxhi Zeka” n Istog. Nd rsa studimet i fillova n Universitetin e Gjakov s “Fehmi Agani” Fakulteti i Edukimit – Programi Fillor.

## LITERATURA

Dauti, Esad, Hoxha, ,Esat , Mustafa, Behxhet, Rrustemi, Ragip, Biologjia, Shtetia botuese DUKAGJINI – Pej , P r klasën e shtat t shkollës s mesme t ult

Gashi, Agim, Halili, Fetah, Bajraktari, Bajraktari, Ajazaj, Hamdi, Njeriu dhe natyra, P r klasën e pest t shkollës fillore

Morris G. Charles, Maisto A. Albert, Psikologjia shkenca e proceseve mendore dhe e sjelljes njerëzore, Qendra p r Arsim Demokratik, Tiran , 2008

Nushi, Pajaziti, Psikologjia e përgjithshme I, Libri shkollor, Prishtin , 2002

Juniku, Neki, Nocione themelore psikologjike, Prishtin , 1985

Juniku, Neki, Kaptina nga psikologjia, Prishtin ,2015

Shahini, Mimoza, Seminare t zgjedhura nga lnda e psikofiziologjisë, Prishtin , 2007

## BURIME NGA INTERNETI

<http://psikologji.net/forumi/index.php?topic=2187.0>

<http://www.germ-a.com/wp-content/uploads/2014/07/perceptimi-ndertimi-mendor.pdf>

<https://www.google.com/search?q=shqisat+e+njeriut&sa=X&rlz>

[https://www.google.com/search?q=shqisat+e+te+degjuarit&rlz=1C1CHZL\\_enXK723XK723&biw=1440&bih=745&source=lnms&tbn=isch&sa=X&ved=0ahUKEwuuue73aHUAhXkK5oKHfsTCzIQ\\_AUIDCgD#tbn=isch&q=preceptimi&imgsrc=PC1Y1J8MPInGfM:](https://www.google.com/search?q=shqisat+e+te+degjuarit&rlz=1C1CHZL_enXK723XK723&biw=1440&bih=745&source=lnms&tbn=isch&sa=X&ved=0ahUKEwuuue73aHUAhXkK5oKHfsTCzIQ_AUIDCgD#tbn=isch&q=preceptimi&imgsrc=PC1Y1J8MPInGfM:)















